



**RAPORTI VJETOR I PUNËS SË  
KËSHILLIT TË KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE  
PËR VITIN 2018**

**Mars 2019**

# PËRMBAJTJA

<b>SHKURTESAT</b> .....	3
<b>1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	4
<b>2. KORNIZA LIGJORE</b> .....	5
<b>2.1. Baza ekzistuese ligjore</b> .....	5
<b>2.2. Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet</b> .....	5
<b>3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT</b> .....	6
<b>3.1. Misioni</b> .....	6
<b>3.2. Vizioni</b> .....	6
<b>3.3. Kompetencat dhe përgjegjësitë e KKTK-së</b> .....	7
<b>4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI</b> .....	8
<b>4.1. Bordi</b> .....	8
<b>4.2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit</b> .....	9
<b>4.3. Sekretariati</b> .....	9
<b>4.4. Burimet Njerëzore</b> .....	10
<b>4.5. Asetet e KKTK</b> .....	10
<b>5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE</b> .....	11
<b>6. REKOMANDIMET / SFIDAT DHE TË GJETURAT E KKTK-së</b> .....	16
<b>8. SHTOJCAT</b> .....	20
<b>1. Raporti për projektet e investuara në trashëgimi kulturore 2008-2018</b> .....	20
<b>2. Identifikimi i prioriteteve financiare për trashëgimi kulturore për vitin 2019</b> .....	20
<b>3. Kërkesa për anëtarësim në JPICH</b> .....	20

## **SHKURTESAT**

**KKTK** – Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

**MKRS** – Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

**LTK** – Ligji për Trashëgimi Kulturore

**LZVM** – Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura

**LQHP** – Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit

**KZM** – Këshilli Zbatues dhe Monitorues

**UNESCO** - United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization

**KE** – Këshilli i Evropës

**ASHI** – Agjencia e Shoqërisë së Informacionit

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) si agjenci e pavarur e Kuvendit të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018, ka arritur që me sukses të përmbush shumicën e objektivave të parapara në planin vjetor të punës dhe Strategjisë afatmesme të KKTK-së. KKTK ka arritur që gjatë vitit 2018 të nxjerr të gjitha aktet nënligjore të cilat rregullojnë mënyrën e vlerësimit dhe shpalljes së trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, ka arritur të hartojë dhe miratojë formularin për aplikim dhe detyra të tjera. Ka organizuar punëtorë dhe ka prezantuar raporte periodike dhe përmbledhëse për gjendjen e trashëgimisë kulturore.

KKTK nga 23 korriku 2018 si rezultat e përfundimit të mandatit të anëtarëve të Bordit, është duke funksionuar pa trupën vendimmarrëse Bordin. KKTK në koordinim dhe bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Kosovës, konkretisht me Komisionin për Arsim ka hapur konkursin dhe ka zhvilluar të gjitha procedurat për emërimin e anëtarëve të Bordit të KKTK-së, deri në fund të dhjetorit 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka arritur të emëroj anëtarët e Bordit të KKTK-së, përkundër që në disa seanca ka qenë si pikë e rëndit të ditës, mirëpo për shkak të mungesës së korumit nuk është arritur të votohet.

Sot në KKTK është duke funksionuar Sekretariati, si njësi mbështetëse, profesionale dhe administrative, dhe në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të veta po kryen detyrat e veta që ka.

KKTK ka arritur që me sukses të përmbush mbi 70 % të Planit të Punës për vitin 2018, dhe si rezultat i mungesës së anëtarëve të Bordit nuk është arritur të përmbushet edhe pjesa tjetër e objektivave të parapara. Gjithashtu KKTK është përballur më probleme funksionale, pasi që Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit nuk i ka kryer obligimet e veta ligjore që ka në dorëzimin e projekteve për vlerësim në KKTK. Po ashtu gjatë vitit 2018 nuk kemi pasur asnjë propozim nga institucionet e trashëgimisë kulturore për shpallje në mbrojtje të përhershme të aseteve të trashëgimisë kulturore. Edhe Këshilli Zbatues Monitorues përgjatë vitit 2018, nuk ka ofruar bashkëpunim më KKTK, përkundër që kemi pasur takime zyrtare më përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe OSCE-së, dhe janë diskutuar gjëra të përgjithshme për zonat e veçanta të mbrojtura të trashëgimisë kulturore.

Disa nga objektivat e KKTK-së të cilat përmes aktiviteteve konkrete synohen të arrihen gjatë vitit 2019 janë:

- Vlerësimi dhe shpallja e trashëgimisë kulturore
- Bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare
- Promovimi dhe fuqizimi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore
- Menaxhimi dhe administrimi i buxhetit të KKTK

## **2. KORNIZA LIGJORE**

### **2.1. Baza ekzistuese ligjore**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) është agjenci e pavarur e themeluar në përputhje me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është krijuar nga Kuvendi i Kosovës në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore Nr. 02/L-88.

KKTK kompetencat dhe përgjegjësitë i ka të përcaktuara në bazë të:

Ligjit Nr. 02/L-88 Për Trashëgimi Kulturore

Ligjit Nr. 03/L-039 Për Zonat e Veçanta të Mbrojtura

Ligjit Nr. 04/L-066 Për Qendrën Historike të Prizrenit

Gjithashtu KKTK ka edhe aktet e veta nënligjore që rregullojnë mënyrën e organizimit dhe funksionimit:

1. Rregullorja 01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore
2. Rregullorja 02/2016 për Vlerësimin dhe Shpalljen e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përhershme

### **2.2. Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet**

KKTK përgjatë vitit 2018 nuk ka arritur të përmbush mandatin ligjorë që ka në vlerësimin e projekteve të trashëgimisë kulturore, obligim dhe përgjegjësi e KKTK në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore neni 5 pika 2, pasi që MKRS përgjatë vitit 2018 nuk ka dorëzuar asnjë projekt për vlerësim në KKTK, siç e obligon Ligji për Trashëgimi Kulturore. Gjithashtu përcaktimi i prioritetëve financiare nga ana e KKTK-së nuk ka arritur të bëhet, pasi që MKRS nuk ka bashkëpunuar me KKTK-në në këtë drejtim.

Moszbatimi i LTK dhe e ligjeve tjera të aplikueshme që ndërlidhen me fushën e trashëgimisë kulturore ka reflektuar në gjendjen e keqe të trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe ka paraqitur probleme në përmbushjen mandatit ligjor që ka KKTK.

Prandaj, edhe në vitin 2018 mund të konstatojmë se ka munguar bashkëpunimi adekuat ndërinstitucional rreth mbrojtjes ligjore të trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër edhe KKTK ka hasur në vështirësi gjatë realizimit dhe zbatimit të kompetencave në përmbushjen e misionit të tij. KKTK disa herë ka kërkuar nga MKRS që të dorëzoj të gjitha projektet e trashëgimisë kulturore për vlerësim ashtu siç është e përcaktuar më Ligjin për Trashëgimi Kulturore neni 5.2.

Si rezultat i moszbatimit të kësaj dispozite ligjore nga MKRS, gjendja e trashëgimisë kulturore vazhdon të mos jetë e mirë. Mos vlerësimi i projekteve nga KKTK, bënë që orientimet dhe prioritetet në trashëgimi kulturore të orientohen keq dhe në raste të shumta projektet që realizohen në trashëgimi kulturore dështojnë dhe asetet vazhdojnë të jenë të mbyllura ose të mos përfundohen.

Këshilli Zbatues Monitorues si organ i krijuar në bazë të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura nuk ka bashkëpunuar me KKTK për çështjet që ndërlidhen me trashëgiminë kulturore dhe fetare siç e obligon neni 11.2 i këtij ligji.

### **3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore – KKTK është agjenci e pavarur e themeluar në përputhje me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. KKTK ka në mandat vlerësimin dhe shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme si dhe detyra të tjera në përputhje me Ligjin Për Trashëgimi Kulturore Nr. 02/L-88, Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura Nr. 03/L-039, Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit Nr. 04/L-066, si dhe aktet e veta nënligjore dhe aktet e tjera në fuqi. KKTK vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas LTK, LZV, LQHP. KKTK mbikëqyret nga Bordi i cili përbëhet prej 7 anëtarëve të cilët sipas legjislacionit në fuqi kanë mandat trevjeçar. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në KKTK është 16.

#### **3.1. Misioni**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore angazhohet për një institucion të qëndrueshëm, të pavarur dhe inovativ në vlerësimin e aseteve të trashëgimisë kulturore për shpallje në mbrojtje të përhershme, vlerësimin e pavarur dhe profesional të projekteve, krijimin e komisioneve të pavarura për vlerësimin e trashëgimisë kulturore në rastet e shpronësimeve, shitblerjeve dhe kompensimeve të tjera financiare, përcaktimin e prioriteteve vjetore financiare për trashëgimi kulturore, si dhe detyrave të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Trashëgimia kulturore do të ketë trajtim të pavarur dhe profesional në përputhje me legjislacionin vendor dhe konventat ndërkombëtare

#### **3.2. Vizioni**

Të jetë një institucion publik i pavarur në fushën e trashëgimisë kulturore në nivel shtetëror, në përmbushjen e detyrave ligjore dhe kushtetuese; Institucion modern i qëndrueshëm, i pavarur

dhe inovativ në nivel më të lartë evropian, duke respektuar standardet dhe kriteret ndërkombëtare në vlerësimin e trashëgimisë kulturore; Rritja e vetëdijes së komunitetit dhe interesit publik në trashëgimi kulturore brenda dhe jashtë vendit. Përkushtimi i stafit profesional mbi rëndësinë dhe vlerën e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës.

### **3.3. Kompetencat dhe përgjegjësitë e KKTK-së**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës ka këto detyra dhe përgjegjësi të punës:

1. Shqyrton, vlerëson, aprovon apo refuzon trashëgiminë kulturore të propozuar për shpallje në mbrojtje të përhershme;
2. Propozon hartimin e Politikës Nacionale për Trashëgimi Kulturore;
3. Vlerëson projektet e propozuara të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse;
4. Asiston Kuvendin e Republikës së Kosovës në plotësim- ndryshimet e ligjeve që kanë të bëjnë me trashëgimi kulturore;
5. Siguron mjete apo donacione për intervenime dhe çështje të tjera në trashëgimi kulturore;
6. Themelon Komisione të pavarur për vlerësimin e kompensimit të aseteve në rast shitblerje, shpronësimi apo për ndonjë humbje financiare që ka ndodhur në asete të evidentuara që kanë karakter të mbrojtjes së përkohshme ose përhershme;
7. Mbikëqyr Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS) gjatë hartimit të listës së aseteve të trashëgimisë kulturore në rrezik;
8. Identifikon dhe i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës prioritetet vjetore për mbështetje financiare të trashëgimisë kulturore;
9. I propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës ndërmarrjen e masave të nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe i ofron asistencë teknike Qeverisë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore në Republikën e Kosovës nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria;
10. Bashkëpunon me MKRS dhe Institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare si UNESCO, Këshilli i Evropës etj, për çështje të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës, bazuar në Ligjin për Trashëgimi Kulturore, ligjet e tjera në fuqi si dhe konventat dhe standardet ndërkombëtare;
11. Bashkëpunon me Këshillin Zbatues dhe Monitorues (KZM) mbi çdo çështje që ka lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës sipas Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura;
12. Rivlerëson apo rishikon Qendrën e mbrojtur historike të Prizrenit me të gjitha elementet e saj, bazuar në Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.
13. Detyra të tjera të parapara me ligj.

## **4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI**

KKTK përbëhet nga Bordi prej shtatë (7) anëtarëve dhe Sekretariati prej nëntë (9) nëpunësve civil. KKTK udhëhiqet nga kryetari i cili zgjidhet nga Anëtarët e Bordit. Sekretariati udhëhiqet nga Udhëheqësi Ekzekutiv i cili është përgjegjës për të gjitha punët administrative dhe punët e përditshme të KKTK-së. Në bazë të Rregullores 01/2016 Për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore janë të parapara krijimi i këtyre Departamenteve: Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Departamenti i Peizazheve Kulturore, Departamenti i Gjeobazës, Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa. KKTK është në proces të plotësim – ndryshimit dhe do të ketë një riorganizim më praktik të këtyre departamenteve.

Anëtarët e Bordit janë emëruar më 23 korrik 2015 dhe mandati i tyre ka përfunduar më 23 korrik 2018, bazuar në Ligjin për Trashëgimi Kulturore neni 4.8.

### **4.1. Bordi**

Bordi i KKTK përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të përfaqësuar nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Republikën e Kosovës;

Mandati i anëtarëve të Bordit është tre (3) vjeçar;

Anëtarët e Bordit të KKTK-së zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Bordi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në kuadër të kompetencave ligjore që ka, deri në përfundim të mandatit me 23 korrik 2018 ka mbajtur disa mbledhje të rregullta dhe disa takime konsultative. Bordi i KKTK ka miratuar vendime, ka nxjerrë rekomandime dhe është në proces të plotësim ndryshimit të rregulloreve ekzistuese dhe hartimit të rregulloreve të tjera të nevojshme për funksionalizimin dhe fuqizimin e KKTK-së.

Anëtarë të Bordit të KKTK-së kanë qenë:

1. z. Shafi Gashi, kryetar
2. z. Florim Isufi, nënkryetar
3. znj. Doruntinë Matoshi, nënkryetare
4. z. Filko Jovanović, anëtar
5. z. Visar Haxhibeqiri, anëtar
6. znj. Arjetë Miftari, anëtare
7. z. Bego Kululleri, anëtar



## **4.2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit**

- Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe nënkryetaret e KKTK;
- Përcakton trashëgiminë kulturore në mbrojtje të përhershme;
- Miraton buxhetin e KKTK;
- Miraton te gjitha vendimet e KKTK;
- Themelon komisione të pavarura për çështje të ndryshme të trashëgimisë kulturore dhe KKTK-së;
- Miraton raportin e punës vjetor të KKTK-së;
- Nxjerr akte nënligjore;
- Formon grupe punuese për kryerjen e detyrave të caktuara;
- Zgjedh dhe shkarkon Udhëheqësin Ekzekutiv të KKTK, sipas procedurave të parapara me legjislacionin në fuqi;
- Vlerëson punën dhe përformancën e Udhëheqësit Ekzekutiv të KKTK-së;

## **4.3. Sekretariati**

Sekretariati është organ mbështetës profesional, administrative dhe teknike për nevoja të KKTK-së, i cili përbehet nga nëntë (9) nëpunës civil qe kane detyra të caktuara në përmbushjen e përgjegjësiive dhe mandatit qe ka KKTK;

Sekretariati udhëhiqet nga Udhëheqësi Ekzekutiv;

Ofron shërbime profesionale dhe këshilluese për Bordin, për te mundësuar një vendimmarrje të drejt;

Përgatit propozimin për buxhetin vjetor te KKTK-se të cilin ia paraqet Bordit për miratim;

Sigurimin e shërbimeve mbështetëse lidhur me organizimin dhe zhvillimin me sukses të takimeve të Bordit dhe takimeve të tjera;

Përgatit dokumente dhe materiale sipas nevojave të punës dhe kërkesave të Bordit;

Zhvillon shërbimet e ndërlydhura me planifikimin, rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore;

Planifikon dhe shpenzon buxhetin si dhe kryerjen e pagesave të KKTK në përputhje me procedurat ligjore;

Ofron shërbime të tjera mbështetëse të cilat me vendime të posaçme kërkohen nga Bordi;

Sekretariati përbehet nga Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Departamenti për Peizazhe Kulturore, Departamenti i Gjeobazes, Departamenti i Shërbimeve te Përgjithshme, Departamenti i Buxhetit dhe Financave, Divizioni për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore te Paluajtshme, Divizioni për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore te Luajtshme, Divizioni i Burimeve Njerëzore.


#### 4.4. Burimet Njerëzore

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore deri më 23 korrik ka pasur shtatë (7) anëtarë të Bordit të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe nëntë (9) nëpunës civil. Bazuar në këtë numër të vogël të punëtorëve, KKTK ka nevoja urgjente edhe për të paktën pesë (5) pozita të punës profesionale.

Punonjësit e Sekretariatit gjatë vitit 2018, kanë ndjekur trajnime të cilat lidhen më detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të punës, kanë marrë pjesë në konferenca dhe takime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

#### 4.5. Asetet e KKTK

Për kryerjen e aktiviteteve të veta, KKTK ka në posedim dy (2) vetura, kompjuterë si dhe mobile dhe pajisje të tjera. Shumica e kompjuterëve dhe pajisjeve tjera janë amortizuar dhe kërkohet ndërrimi i tyre. KKTK është e vendosur në kontejnerët pranë ndërtesës së ish Rilindjes, dhe në kushte jo të mira të punës. Përgjatë stinës së dimrit kemi pasur probleme më ngrohje dhe ujë, kurse gjatë stinës së verës temperaturat janë shumë të larta.



*Lokacioni: Kompleksi Rilindja, Kontejneri nr. 3. 10000, Prishtinë*

## 5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore që ka, përgjatë vitit 2018 ka ndërmarr veprime dhe ka realizuar aktivitete konkrete me qëllim të përmirësimit të gjendjes së trashëgimisë kulturore. Gjithashtu ka hartuar raporte informuese dhe analitike për gjendjen e trashëgimisë kulturore. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2018 në KKTK nga institucionet varëse të MKRS nuk është dorëzuar për vlerësim dhe shpallje në mbrojtje të përhershme asnjë aset i trashëgimisë kulturore. Duke pas parasysh se gjatë viteve të fundit për herë të parë është realizuar vlerësimi dhe shpallja e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, KKTK ka arritur që me sukses të përmirësoj shërbimet dhe format e propozimeve. Për të pasur një procedurë transparente, llogaridhënëse dhe me efikasitet, nga forma e plotësimit të aplikacionit me shkrim, KKTK ka arritur që me sukses të zhvillojë platformën elektronike për propozim shpallje në mbrojtje të përhershme. Qasje në platformë do të kenë të gjithë zyrtaret të cilët caktohen nga institucionet vartëse të MKRS. Platforma si mjet mjaft i rëndësishëm është zhvilluar gjatë vitit 2018, kurse ka hyrë në funksion në vitin 2019.

KKTK gjatë vitit 2018 është munduar të krijojë të gjitha parakushtet, duke nxjerrë dokumente dhe akte të tjera të cilat do të lehtësoj procesin e vlerësimit dhe shpalljes së trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme. Sfidë për KKTK-në vazhdon të mbetet moszbatimi i Ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe ligjeve të tjera të fushës nga MKRS, dhe si rezultat i kësaj KKTK po e ka të vështirë realizimin dhe arritjen e objektivave programore që ka.

Përveç transparencës së plotë në procesin e vlerësimit dhe shpalljes së trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, KKTK përgjatë vlerësimit të projekteve të cilat do të dorëzohen nga MKRS në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore neni 5 pika 2, do të transmetojë drejtpërdrejtë të gjitha takimet dhe mbledhjet ku do të trajtohen dhe vlerësohen projektet.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore deri më 23 korrik 2018, ka funksionuar në përbërje të plotë të anëtarëve të Bordit dhe Sekretariati. Kurse nga kjo datë KKTK nuk ka anëtarët e Bordit si trupë vendimmarrëse në kuadër të KKTK-së, gjë që është duke shkaktuar probleme dhe ngecje mjaft të mëdha për institucionin, mirëpo edhe për Republikën e Kosovës, pasi që i vetmi institucion i cili ka përgjegjësi ligjore për vlerësimin dhe shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, vlerësimin e projekteve, caktimin e vlerës monetare në rastet e shpronësimeve dhe shitblerjeve në trashëgimi kulturore është KKTK, dhe sot mungesa e anëtarëve të Bordit paraqet ngecje për trashëgiminë kulturore në Republikën e Kosovës.

Gjithsesi, përkundër vështirësive që ka pasur institucioni përgjatë vitit 2018, dhe mungesës së anëtarëve të Bordit nga mesi i vitit 2018, KKTK ka arritur që të realizojë shumë aktivitete të cilat i ka pasur të parapara në kuadër të planit dhe programit të punës për vitin 2018. Gjithashtu një problem i theksuar në mosarritjen e të gjitha objektivave mbetet mosbashkëpunimi i MKRS

më KKTK në relacion me vlerësimin e projekteve, mungesën e propozimeve për shpallje, prioritetet vjetore financiare dhe punë të tjera të përbashkëta.

Disa nga aktivitetet të cilat KKTK ka realizuar në vitin 2018 janë:

- **Raporti për gjendjen e trashëgimisë kulturore**

KKTK në kuadër të mandatit dhe detyrave që ka në fushën e trashëgimisë kulturore ka hartuar raportin për gjendjen e trashëgimisë kulturore. Ky raport paraqet një pasqyrë dhe analizë të gjendjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës. Raporti përmban analizën e gjendjes sipas kategorive të trashëgimisë kulturore për të cilat MKRS ka ndarë mjete buxhetore për realizimin e projekteve të ndryshme kapitale.

Në bazë të vlerësimit të gjendjes dhe të dhënave të mbledhura, KKTK ndër të tjera ka konstatuar se gjendja e rëndë e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës vjen si rezultat i planifikimit jo të mirë të prioritetëve financiarë, realizimit ad hoc të projekteve, mosvlerësimit të projekteve nga institucioni kompetent (KKTK) siç parashihet në bazë të Ligjit për trashëgimi kulturore. Gjithashtu projektet nuk planifikohen dhe realizohen sipas një plani afatmesëm/afatgjatë dhe sipas një analize për ndërhyrje emergjente konservuese/restauruese. Ndërhyrjet realizohen nga kompanitë ndërtimore të palicencuara si dhe problematika të tjera që paraqiten në kuadër të raportit.

Buxheti i ndarë për çdo vit nuk përmbush pritjet dhe nevojat që ka trashëgimia kulturore e vendit. Megjithëse në periudhën 2008 – 2018 janë ndarë jo pak mjete financiare për projekte të ndryshme kapitale, një gjë e tillë nuk korrespondon me përmirësimin e gjendjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës. MKRS ka hartuar listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme që përmban gjithsej 1595 asete nga të gjitha kategoritë ligjore, me më së shumti nga trashëgimia arkitekturale dhe arkeologjike. Kosova ka 23 asete në mbrojtje të përhershme që nga viti 2016 të shpallura nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

KKTK si në të kaluarën edhe gjatë hartimit të raportit i ka kërkuar bashkëpunim MKRS-së, për arritjen e qëllimit të përbashkët dhe adresimin e sfidave e problemeve me të cilat përballet trashëgimia kulturore. Me gjithë mungesën e bashkëpunimit të MKRS në ofrimin e të dhënave lidhur me projektet e realizuara në periudhën 2008-2018, KKTK ka vazhduar punën për përgatitjen e raportit gjithëpërfshirës duke përdorur burime zyrtare të publikuara, ka zhvilluar vizita pune në terren dhe takime me akterë për të parë nga afër gjendjen e aseteve të trashëgimisë kulturore në të cilat ka intervenuar MKRS.

Duhet theksuar se ky raport merr në shqyrtim vetëm projektet kapitale nga MKRS dhe jo projektet që janë zhvilluar nga subvencionet dhe projektet e zhvilluara nga komunat apo projektet e financuara nga fonde ndërkombëtare. KKTK gjatë vitit 2018, është angazhuar

maksimalisht në hartimin e këtij raporti, që konsiderojmë se është një pasqyrë mjaftë e qartë e gjendjes së trashëgimisë kulturore.

- **Zhvillimi i platformës elektronike për propozim shpallje në mbrojtje të përhershme**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore gjatë vitit 2018, ka zhvilluar platformën elektronike për propozim shpallje të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme. Zhvillimi i kësaj platforme është një e arritur e madhe jo vetëm për KKTK-në si institucion, mirëpo edhe për Republikën e Kosovës, pasi që nga viti 2019 i tërë procesi i vlerësimin dhe shpalljes së trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme do të bëhet në mënyrë elektronike. Platforma mundëson që procesi të jetë transparent, llogaridhënës dhe shkurton kohën dhe procesin në trajtimin e propozimeve që bëhen nga MKRS, përmes institucioneve të saja vartëse. Qasja në platformë kanë të gjithë zyrtaret të cilët propozohen nga MKRS. Administrimi i platformës bëhet nga KKTK si institucion përgjegjës, kurse hostimi dhe siguria garantohen nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI).

- **Aplikimi për anëtarësim në Joint Programming Initiative on Cultural Heritage**

KKTK gjatë vitit 2018, ka aplikuar që të jetë anëtarë i Joint Programming Initiative on Cultural Heritage, iniciativë e disa shteteve anëtare të Evropës të cilat kanë krijuar programin për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore përmes përkrahjes në hulumtim dhe zhvillim të trashëgimisë kulturore. Joint Programming Initiative on Cultural Heritage ka 18 shtete anëtare dhe 7 shtete vëzhguese. Shtete anëtare të këtij programi janë: Franca ( Koordinatorë), Bjellorusia, Belgjika, Qipro, Republika Çeke, Irlanda, Italia, Latvija, Lituania, Moldovia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar. Kurse shtete vëzhguese janë: Austria, Bullgaria, Estonia, Gjermania, Greqia, Izraeli dhe Sllovakia. Republika e Kosovës, nëse arrin të anëtarësohet në këtë program do të ketë të drejta të barabarta sikurse shtetet e tjera. Do të ketë 2 anëtarë në Bordin drejtues dhe 1 anëtar në Bordin ekzekutiv. Besojmë se më anëtarësimin e Republikës së Kosovës në këtë program do të jetë një mundësi e mirë për thithjen e fonëve për trashëgimi kulturore, por edhe një mundësi e mirë për lobim në anëtarësimin e Republikës së Kosovës në UNESCO.

- **Punëtori për trashëgimi kulturore**

KKTK gjatë vitit 2018, ka organizuar disa punëtori për trashëgimi kulturore, janë trajtuar tema të ndryshme për gjendjen e trashëgimisë kulturore, është diskutuar për zonat e mbrojtura dhe zonat rrethuese. Disa nga punëtorit që janë organizuar gjatë vitit 2018 janë: Punëtorja për zonat e mbrojtura dhe zonat rrethuese, Prezantimi i aplikacionit për shpallje ne mbrojtje të përhershme, Prezantimi i raportit për gjendjen e trashëgimisë kulturore 2008 – 2018, si dhe punëtori dhe takime të tjera formale dhe joformale.

- **Identifikimi i masave të domosdoshme financiare – prioritetet**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore neni 4.9 në vitin 2018 ka bërë identifikimin e masave të domosdoshme të mbështetjes financiare për trashëgimi kulturore. Në bazë të vlerësimit të gjendjes dhe të dhënave të mbledhura, KKTK ndër të tjera ka konstatuar se gjendja e rëndë e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës vjen edhe si rezultat i planifikimit jo të mirë të prioritetëve financiare. Në kuadër të identifikimit të prioritetëve financiare për trashëgimi kulturore për vitin 2019, është konstatuar se buxheti i planifikuar është mjaftë i ulët dhe nuk garanton përmirësim të gjendjes në këtë fushë.

Gjithashtu edhe planifikimi që është bërë nga MKRS në këtë mënyrë, me projekte të përsëritura për vite të tëra, pa një plan veprimi konkret dhe investime në objekte të cilat nuk e kanë statusin e asetit të trashëgimisë kulturore, nuk do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës. Prioritet për investime duhet të kenë asetet e trashëgimisë kulturore në mbrojtje.

Si institucion konsiderojmë se trashëgimia kulturore sot përveç që ka nevoja të mëdha për intervenime dhe përmirësim të gjendjes fizike, duhet bërë promovimi përmes botimeve dhe publikimeve shkencore. Prandaj, një pjesë e konsiderueshme e mjeteve financiare duhet të ndahen për këtë destinim.

Në kuadër të obligimit ligjor që kemi në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore neni 4.9 në afatet e parapara ligjore KKTK ka dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës listën e prioritetëve financiare në trashëgimi kulturore.

- **Pjesëmarrja në konferenca dhe takime vendore dhe ndërkombëtare**

Zyrtarët e KKTK-së përgjatë vitit 2018 kanë marrë pjesë në shumë konferenca dhe takime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Në të gjitha këto konferenca dhe takime KKTK ka provuar që të vendosë kontakte dhe të promovojë trashëgiminë tonë të pasur kulturore.

- **Avancimi dhe përditësimi i Web faqes zyrtare të KKTK-së**

KKTK gjatë vitit 2018 ka përditësuar webfaqen e institucionit, duke mundësuar që tërë veprimtaria dhe puna e KKTK të promovohet. KKTK në kuadër të webfaqes ka mundësuar transparencë të plotë në procesin e vlerësimit dhe shpalljes së trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme. Gjithashtu është zhvilluar transparenca e plotë në procesin e mbajtjeve të mbledhjeve, duke i mundësuar qytetareve që mbledhjet e Bordit të KKTK-së të transmetohen drejtpërdrejtë përmes kamerës. Në kuadër të webfaqes së përditësuar të gjithë të interesuarit mund të gjejnë informacione për dhe rreth trashëgimisë kulturore, mund të lexojnë dhe informohen për asetet e shpallura në mbrojtje të përhershme dhe informata të tjera të nevojshme.

## **6. REKOMANDIMET / SFIDAT DHE TË GJETURAT E KKTK-së**

KKTK në kuadër të fushëveprimtarisë së vet përgjatë vitit 2018, ka identifikuar disa rekomandime konkrete të cilat mendojmë se nëse do të zbatohen, gjendja e trashëgimisë kulturore do të jetë në nivel me të mirë. Po ashtu KKTK është përballur edhe me sfida të cilat përmes të gjeturave që kemi identifikuar kanë ndikuar në mosarritjen e të gjitha objektivave dhe po ashtu kanë ndikuar në gjendjen jo të mirë të trashëgimisë kulturore.

Disa nga rekomandimet e KTKK-së janë:

1. Respektimi i Ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe ligjeve tjera të fushës
2. Vlerësimi i projekteve nga ana e institucionit kompetent – Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
3. Përcaktimi i qartë i prioriteteve financiare vjetore për trashëgimi kulturore nga institucioni përgjegjës – Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
4. Mbikëqyrja e ndërhyrjeve restauruese/konservuese nga ana e institucioneve përgjegjëse
5. Mbikëqyrja dhe survejimi arkeologjik gjatë projektimit të autorrugëve dhe veprave infrastrukturore në Kosovë
6. Ndarja e mjeteve buxhetore për shpronësimin e aseteve të trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë
7. Bashkëpunimi me pronarët e aseteve të trashëgimisë kulturore
8. Përfshirja e komunitetit ku shtrihen asete të trashëgimisë kulturore
9. Licencimi i personave juridik dhe fizik për ndërhyrje konservuese/restauruese të trashëgimisë kulturore
10. Licencimi i personave juridik dhe fizik që bëjnë gërmime arkeologjike.
11. Licencimi i personave fizik dhe juridik që merren me shitjen dhe blerjen e objekteve të trashëgimisë së luajtshme
12. Shenjëzimi dhe ndriçimi i trashëgimisë kulturore në përputhje me standardet ndërkombëtare
13. Botimet dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
14. Promovimi i diversitetit kulturor si vlerë e përbashkët
15. Rritja e stafit profesional në institucionet e trashëgimisë kulturore
16. Realizimi i projekteve të bëhet në bazë të prioriteteve, gjendjes faktike dhe arsyeshmërisë.



Disa nga sfidat dhe të gjeturat e KKTK-së:

1. Mungesa dhe domosdoshmëria e vlerësimit të projekteve dhe përcaktimi i prioriteteve nga ana e KKTK paraqitet si çështje kryesore që do të kontribuonte në ndaljen e shkatërrimit të trashëgimisë kulturore. Nga themelimi në KKTK nuk është dorëzuar asnjë projekt për vlerësim nga institucionet e MKRS, siç përcaktohet në nenin 5.2 të Ligjit për Trashëgimi Kulturore. Të gjitha këto projekte vlerësohen nga një Komision që funksionon në kuadër të MKRS-së i themeluar në kundërshtim me ligjin. Si rezultat i kësaj praktike dhe moszbatimit të ligjit, projektet janë realizuar dhe realizohen në kundërshtim me kriteret dhe standardet profesionale si dhe shumë mjete buxhetore shpenzohen në objekte të cilat nuk gëzojnë status të mbrojtjes ligjore
2. Përkundër rritjes së buxhetit dhe investimeve të vazhdueshme, shpeshherë në projekte të njëjta, trendi i degradimit dhe shkatërrimit të aseteve të trashëgimisë kulturore aktualisht nuk shënon rënie. Përkundrazi, shkatërrimi vazhdon sidomos në zonat urbane dhe në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës
3. Mungesa e licencimit të kompanive siç parashihet me nenin 4.16 të LTK e të cilat bëjnë punime restauruese/konservuese dhe ndërhyrje tjera rezulton të jetë një nga shkaktarët kryesorë të dëmtimit dhe ndërhyrjeve joprofesionale e jocilesore në asetet e trashëgimisë kulturore
4. Gjendja e aseteve të trashëgimisë arkeologjike mbetet e pakonsoliduar, megjithë investimet e përvitshme dhe me projekte të vazhdueshme. Gjithashtu, gjërat me karakter shpëtimi shpeshherë bëhen edhe në lokalitete të njohura arkeologjike, të cilat nuk janë të rrezikuara nga ndikimet apo dëmtimet e faktorëve natyror dhe njerëzor. Problematike mbetet çështja e pronësisë së tokës private ku shtrihet trashëgimia arkeologjike
5. Mungesa e licencimit të personave juridik dhe fizik që bëjnë gjëra arkeologjike sipas nenit 7.21 të LTK paraqet shkelje ligjore me pasoja për trashëgiminë arkeologjike të vendit.
6. Trafikimi i objekteve të luajtshme paraqet dëmtim dhe humbje të trashëgimisë kulturore, pasi që nuk bëhet në përputhje me nenin 9.26 të LTK i cili parasheh licencimin e personave fizik dhe juridik që merren me shitjen-blerjen e artefakteve
7. Kthimi i thesarit arkeologjik dhe etnologjik të Kosovës që është plaçkitur nga Serbia në vitet 1998/99, mbetet çështje e pazgjidhur, përkundër mjeteve të ndara për disa vite nga MKRS për këtë linjë buxhetore. Nuk dihet se çfarë është realizuar në këtë drejtim pasi nuk ka ndonjë politikë programore, fushatë dhe asnjë rezultat për kthimin e artefakteve.

8. Mungesa e kontrollit dhe llogaridhënies në trashëgimi kulturore rezulton si sfidë për institucionet në parandalimin e shkatërrimeve të qëllimshme apo për shkaqe tjera të ndryshme (natyrore, vjetërsia, mosmirëmbajtja etj)
9. Ridestnimi i mjeteve për trashëgimi kulturore nga MKRS vjen si rezultat i planifikimit të dobët dhe mospërfundimit me kohë të projekteve
10. Mosbashkëpunimi i MKRS-së me pronarët e aseteve që gëzojnë statusin e mbrojtjes së përkohshme paraqitet si sfidë. Në këtë aspekt, mund të thuhet se mungon pothuajse tërësisht komunikimi dhe njoftimi i pronarëve lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre duke humbur mundësinë për involvimin e komuniteti si akterë aktivë dhe promotorë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në shumë raste pronarët nuk janë të informuar për ndërhyrjet dhe projektet që zhvillohen në objektet e tyre. Si rezultat i kësaj dhe interesave të ndryshme ekonomike, sociale, të sigurisë e tjera, shpeshherë pronarët e objekteve/aseteve tentojnë që ato ti heqin nga lista e trashëgimisë kulturore duke mos zgjedhur mënyra për arritjen e këtij qëllimi. Shtytës i kësaj është edhe presioni nga zhvillimi urban në dhe përreth qendrave të qyteteve, ku edhe zakonisht janë të vendosura asetet e trashëgimisë kulturore
11. Vazhdimi i statusit për cdo vit nga MKRS për asete që janë pjesë e listës së përkohshme është në kundërshtim me Ligjin për trashëgimi kulturore, neni 3.6 pasi ato nuk mund të jenë më shumë se një vit në mbrojtje të përkohshme. MKRS gjatë kësaj periudhe të mbrojtjes së përkohshme është e obliguar të përgatit dokumentacionin e nevojshëm dhe ta përcjellë në KKTK për shpallje në mbrojtje të përhershme
12. Shtimi i numrit të aseteve në listën e mbrojtjes së përkohshme pa plan për trajtimin dhe shfrytëzimin e tyre mbetet problematikë tjetër
13. Mungesa e stafit profesional në fushat e trashëgimisë kulturore është sfidë dhe një prej shkaktarëve që gjendja mbetet e papërmirësuar. Në të gjitha institucionet e kësaj fushëveprimtarie janë rreth 80 punonjës profesional që mbulojnë fusha të ndryshme të trashëgimisë kulturore
14. Mungesa e shënjëzimit dhe ndriçimit në asetet e trashëgimisë kulturore, në veçanti për njëzetetë (23) asetet e shpallura në mbrojtje të përhershme.

## 7. RAPORTI FINANCIAR

KKTK është organizatë buxhetore me kod organizativ 246 dhe me një (1) programe 25600.

Në bazë të Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018 KKTK ka pasur buxhet në vlerë 218,287.97 euro

Struktura e buxhetit të aprovuar për vitin 2018:

- Paga dhe mëditje: 130,319.97 euro
- Mallra dhe shërbime: 85,418.00 euro
- Shpenzime komunale: 2,550.00 euro

KKTK përkundër shumë kërkesave të parashtruara pran institucioneve përgjegjëse nuk ka pasur buxhet shtesë gjatë këtij viti.

<b>Kodi Ekonomik</b>	<b>Kategoria Ekonomike</b>	<b>Buxheti vjetor me ligjin e buxhetit (2018)</b>	<b>Buxheti përfundimtar 2018</b>	<b>Shpenzimet deri më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Buxheti i shpenzuar (në %)</b>
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>
<b>11000</b>	Paga dhe Mëditje	130,319.97	89,183.18	89,183.18	68.5 %
<b>13000</b>	Mallra dhe Shërbime	85,418.00	85,418.00	62,406.82	73 %
<b>13200</b>	Shpenzime Komunale	2,550.00	1,398.30	867.49	34 %
	<b>Gjithsej</b>	218,287.97	175,999.48	152,457.49	69.84%



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore**  
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

---

## **8. SHTOJCAT**

- 1. Raporti për projektet e investuara në trashëgimi kulturore 2008-2018**
- 2. Identifikimi i prioriteteve financiare për trashëgimi kulturore për vitin 2019**
- 3. Kërkesa për anëtarësim në JPICH**